



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja o) dhe nenit 40.2 shkronja i) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 7 paragrafi 1 dhe 2, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, nenit 5, nenit 6 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 17/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 14/2019 për caktimin e emërtimeve dhe numërtimit të adresave për zona të qarkullimit publik ndërtesa shtëpi objekte dhe parcela kadastrale të lira, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.15 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 00.00.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit

1. Me këtë vendim bëhet plotësimi i listës rezervë për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Rahovecit.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe lista me emërtimet e reja të listës rezervë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shërbime Publike.
3. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- MAPL-së dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr. 240/24
Rahovec: 25.06.2024

Arbër Zenuni
Kryesues i Kuvendit



Niësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 240 Nr. i faq/Br.str/No.pg 67
Data/Datum/Date 25.06 / 2024

Na osnovu člana 12 stav 2, slovo (d), člana 17, slovo o) i člana 40.2, slovo i) Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu Samoupravu Kosova („Službeni list Republike Kosovo“ br. 28/2008), člana 7 stav 1 i 2, člana 10 i člana 11 Zakona br. 04/L-071 za Adresni sistem, člana 5, člana 6 i član 7 Administrativnog uputstva (MSPP) br. 17/2019 za izradu i administriranje azbučnog spiska imena za rezervnu listu i njihovo postavljanje u opštinski registar adresa, člana 5 Administrativnog uputstva MŽSPP br. 14/2019 za dodeljivanje naziva i numeracije adresa za javne prometne površine, zgrade, kuće, objekte i prazne katastarske parcele, člana 10 stav 1 i 2 tačka 2.4, člana 40 i člana 57 stav 1 tačka 1.15 Statuta opštine Orahovac br. 1005 od 29.03.2017.godine, Skupština opštine Orahovac na održanoj sednici 25.06.2024.godine, donosi:

ODLUKU

Za popunjavanje rezervne liste imenovanja ulica i trgova u opštini Orahovac

1. Ovom odlukom popunjava se rezervna lista za imenovanje ulica i trgova u opštini Orahovac.
2. Sastavni deo ove odluke je i lista sa novim imenovanjima rezervne liste.
3. Za sprovođenje ove odluke staraće se odeljenje za urbanizam, planiranje i zaštitu životne sredine i odeljenje za javne usluge.
4. Nakon usvajanja od strane Skupštine opštine Orahovac, ova odluka stupa na snagu 15 dana nakon dostave nadzornom organu, u skladu sa članom 81. Zakona br. 03/L-040 za lokalnu samoupravu i član 8, u vezi sa članom 9 Uredbe (VRK) br. 10/2019 za administrativnu reviziju opštinskih akata, izmenjenih i dopunjenih Uredbom (VRK) br. 06/2021 i 7 dana od dana objave na oglasnoj tabli ili na zvaničnoj internet stranici opštine.

Odluku dostaviti:

- *Predsedniku Opštine,*
- *Odeljenju za Urbanizam, Planiranje i Zaštitu Životne Sredine,*
- *MALS, i*
- *Arhivi.*

SKUPŠTINA OPŠTINE ORAHOVAC

01 Br. 240/24
Orahovac: 25.06.2024

Arber Zenuni
Predsedavajući Skupštine



KOMUNA RAHOVEC

**PROPOZIMET E KOMISIONIT PËR EMËRTIMET E REJA TË
RRUGËVE, SHESHEVE, PARQEVE DHE OBJEKTEVE KOMUNALE**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbr. i Mjedisit
Odeljenje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredine

-XII- Nr. i prot. 185 Më 24.06.2024
Br. prot. Ra. 185/2024
RAHOVEC - ORAHOVAC

PROPOZIMET E KOMISIONIT PËR EMËRTIMET E REJA TË RRUGËVE, SHESHEVE,
PARQEVE DHE OBJEKTEVE KOMUNALE

1

LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozimet e Komisionit për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale
PËR/ZA/TO :	Kuvendin Komunal Rahovec – Anëtarët e Kuvendit Komunal
NGA/OD/FROM:	Komisioni për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale

HYRJE

Me vendim të Kuvendit Komunal Rahovec, është formuar Komisioni për emërtimet e reja të rrugëve, shesheve, parqeve dhe objekteve komunale në këtë përbërje:

1. Albnor Mullabazi -(përfaqësues nga ekzekutivi) - Kryesues i Komisionit
2. Ilir Pallqa- anëtar (përfaqësues nga legjislativi)
3. Arbër Zenuni- anëtar (përfaqësues nga legjislativi)
4. Eqerem Spahiu - anëtar (përfaqësues nga legjislativi)
5. Nora Boshnjaku- anëtare (përfaqësuese nga ekzekutivi).

Komisioni në këtë përbërje ka filluar punimet në terren më datë: 21.09.2023 dhe ka përfunduar ato më datë: 09.10.2023, ndërkaq janë mbajtur edhe katër takime të tjera për shqyrtimin e kërkesave të drejtuara nga qytetarët.

Paraprakisht, Kryesuesi i këtij komisioni Albnor Mullabazi, në dakordim edhe me anëtarët e tjerë kanë caktuar datat e mbajtjes së takimeve me kryetarë të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit, ndërkaq caktimi i lokacionit për mbajtjen e takimeve është bërë në koordinim me përfaqësuesin e fshatit ose lagjes. Ky komision është dakorduar që takimet të mbahen me përfaqësues të disa fshatrave ose lagjeve në një lokacion të përbashkët, me nga një përfaqësues të secilit lokalitet ose edhe anëtarë të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit.

Në vazhdim të evidentuar gjeni edhe orarin e përcaktuar për mbajtjen e takimeve:

Nr		Vendi i mbajtjes së dëgjimit	Data	Ora
1	Opterushë, Zoqisht, Retijë, Retijë e Epërme	Objekti i SHFMU "Lidhja Prizrenit", Opterushë	21.09.2023	18:00
2	Brestoc, Nagac, Hoçë e Vogël	Objekti SHFMU "Heronjtë e Kosovës"	22.09.2023	18:00
3	Krushë e Madhe ,Celinë	Amfiteatri i Kompleksit "Ukshin Hoti", Krushë e Madhe	25.09.2023	18:00

KOMUNA RAHOVEC

**PROPOZIMET E KOMISIONIT PËR EMËRTIMET E REJA TË RRUGËVE, SHESHEVE,
PARQEVE DHE OBJEKTEVE KOMUNALE**

4	Drenoc, Pastaselë, Senoc, Zatriq, Kaznik	"Shtëpia Kulturës" , Drenoc	26.09.2023	18:00	2
5	Pataqan i Epërm, Nushpalë, Pataqan i Poshtëm	Objekti SHFMU " Sakip Bellaqa"	27.09.2023	18:00	
6	Xërxë, Fortesë, Sapniq	"Shtëpia Kulturës" Xërxë	28.09.2023	18:00	
7	Çifllak, Polluzhë, Dobidoj,	Objekti i SHFMU "Rilindja" , Çifllak	29.09.2023	18:00	
8	Kramavik, Guri i Kuq, Mrasor	Objekti SHFMU " Mustaf Ibishi"	02.10.2023	18:00	
9	Ratkoc, Dejnë, Vrajakë, Bratotin,	"Shtëpia e Kulturës", Ratkoc	03.10.2023	18:00	
10	Malësi e Vogël, Gexhë	Objekti SHFMU " Skender Kastrati"	04.10.2023	18:00	
11	Rahovec Lagjet: 1,2	Salla e Kuvendit Komunal	05.10.2023	18:00	
12	Rahovec Lagja: 3	Objekti i SHFMU "Gëzim Hamza-Piktori"	06.10.2023	18:00	
13	Rahovec Lagja 4,5	Objekti i SHFMU "Isa Boletini"	09.10.2023	18:00	

Kryesuesi i komisionit, Albnor Mullabazi, ka hapur punimet e komisionit në secilin lokalitet, poashtu ai ka potencuar se për të qenë më efikas në përfundimin e detyrave dhe përgjegjësi që dalin nga ky komision, kërkojmë nga qytetarët e komunës së Rahovecit, në rast se ka ende rrugë të paemërtuara, sheshe, hapësira ose objekte komunale, që i plotësojnë kriteret në bazë të Ligjit për sistemin e adresave, të konsultohen me qytetarët e lokalitetit që përfaqësojnë për një përfundim sa më të mirë të këtij procesi.

Përfaqësuesit e fshatrave dhe lagjeve urbane, janë njoftuar se kërkesat e tyre mund t'i dorëzojnë çdo ditë pune nga ora 08:00- 16:00, në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, poashtu, Kërkesat, komentet dhe sugjerimet, qytetarët kanë pasur mundësi t'i dërgojnë edhe përmes këtyre email-ve: Albnor.mullabazi@rks-gov.net dhe nora.boshnjaku@rks-gov.net.

Vlen të theksohet se është cekur se iniciativat ose propozimet e këshillave të fshatrave duhet të përmbajnë: Emërtimin e saktë të rrugëve, shesheve, hapësirave ose objekteve komunale, emrin, mbiemrin e parashtruesit si dhe nënshkrimet e nevojshme nga këshillat e fshatrave ose lagjeve urbane varësisht nga kërkesa që parashtrohet.

Takimet e planifikuara janë mbajtur të gjitha, përveç takimit të paraparë në fshatin Opterushë. Procesi ka qenë i gjithi në rregull, por vështirësi, anëtarët e komisionit kanë hasur në paqartësitë e banorëve për

PROPOZIMET E KOMISIONIT PËR EMËRTIMET E REJA TË RRUGËVE, SHESHEVE, PARQEVE DHE OBJEKTEVE KOMUNALE

detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni pasi që ka pasur në vazhdimësi ankesa lidhur me emërtimet e mëparshme të rrugëve në komunën e Rahovecit.

3

Kontribut për mbarëvajtjen e procesit kanë dhënë edhe anëtarët e tjerë të komisionit: të cilët gjatë gjithë kohës janë ndërlidhur aty ku ka qenë e nevojshme të plotësohen informatat për qytetarët, pasi që edhe takimet me qytetarë kanë qenë më shumë të karakterit informues lidhur me procedurat, kriteret se si duhet emërtuar një rrugë, shesh, hapësirë ose objekt komunal.

Në vijim, të bashkangjitur gjeni listën me propozimet e qytetarëve të komunës së Rahovecit, të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe ato që i kanë përmbushur kriteret janë evidentuar në këtë listë për miratim në Kuvendin Komunal të Rahovecit.

PROPOZIMET E KOMISIONIT PËR EMËRTIMET E REJA TË RRUGËVE, SHESHEVE, PARQEVE DHE OBJEKTEVE KOMUNALE

PROPOZIMET

4

I njëjti i'u dërgohet:

- ***Kuvendi Komunal Rahovec***
- ***Anëtarëve të Komisionit për emërtime të reja të rrugëve shesheve, parqeve dhe objekteve komunale në komunën e Rahovecit***
- ***Arkivit***

